



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot.**  
**Nr. Dok. 201302651/5**

**Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014**

**Lënda:** *Rekomandojmë ekzekutimin e vendimit nr.5149 datë 21.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë: "Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, të rillogarisë dhe t'i paguajë paditësit E.Q pensionin parakohshëm për vjetërsi shërbimi si ushtarak sipas nenit 11 të Ligjit nr.8087 datë 13.03.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ushtarakëve të Ministrisë së Rendtit dhe Shërbimit Informativ Kombëtar", i ndryshuar me Ligjin nr.8521 datë 30.07.1999, që nga data 01.11.2011 në shumën 18037 lekë në muaj, e indeksuar sipas rritjeve të viteve 2011-2012 si dhe pagimin e diferencave të krijuara nga moszbatimi korrekt i ligjit nga data 01.01.1999 deri më datë 30.06.2009".*

**Drejtuar:** **Z. Arsim RAMA**  
**Drejtore i Drejtorisë Rajonale**  
**të Sigurimeve Shoqërore**

**TIRANË**

**Për dijeni:** **Znj. Vjollca BRAHO**  
**Drejtorëshë e Përgjithshme e Institutit**  
**të Sigurimeve Shoqërore**

**TIRANË**

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, ka paraqitur ankesë shtetasi E.Q, me objekt: mospërfitim të masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 18037 lekë në muaj.

Sipas shpjegimeve të parashtruara në ankesë dhe dokumentacionit të paraqitur pranë Institucionit tonë, vërejmë se shtetasi E.Q është përfitues i pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Pas rilogaritjes së masës së pensionit sipas Ligjit nr.10142 datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, pensioni i tij pësoi ulje nga 18307 lekë në muaj në 11044 leke në muaj si dhe u deklarua debitor në shumën e 133716 lekëve.

Për të kërkuar të drejtën e tij, ankuesi ka ndjekur rrugën gjyqësore. Konkretisht me vendimin nr. 5149 datë 21.05.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e DRSSH-së që të llogarisë dhe t'i paguajë paditësit pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi si ushtarak sipas nenit 11 të Ligjit nr. 8087 datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar”, i ndryshuar, që nga data 01.11.2011 në shumën e 18037 lekë në muaj, e indeksuar sipas rritjeve të viteve 2011-2012 si dhe pagimin e diferencave të krijuara nga moszbatimi korrekt i ligjit nga data 01.01.1999 deri në datë 30.06.2009.

Kundër këtij vendimi është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.436 datë 21.02.2013, një kopje të së cilës po jua dërgojmë bashkangjitur, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.5149 datë 21.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin e datës 08.04.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar Urdhër Ekzekutim për titullin ekzekutiv të vendimit të sipërcituar. Pas ndjekjes së kësaj procedure, ankuesi ka përfituar pensionin e tij sipas vendimit gjyqësor deri më datë 30.04.2013. Pas kësaj date masa e pensionit nuk i është dhënë më në shumën e 18037 lekëve në muaj, por në atë të 11400 lekëve.

Pas marrjes në shqyrtim të këtij rasti, me shkresën nr.K1/E45-2 datë 06.12.2013, Ju jemi drejtuar me rekomandim për marrjen e masave për dhënien e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 18037 lekë në muaj, sipas vendimit nr. 5149 datë 21.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që nga data 01.05.2013 e në vazhdim shtetasit E.Q.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, me shkresën nr. 13307/1 datë 07.01.2013, ndër të tjera informohemi, se:

*“..Pretendimi për ekzekutimin e vendimit të gjykatës pas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit nr.10142 datë 15.05.2009, i ndryshuar, është zgjidhur përfundimisht me vendimin nr.2 datë 18.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese të republikës së Shqipërisë..”.*

### **Zoti Drejtor,**

Vendimi nr. 5149 datë 21.05.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuptim të nenit 451/ç të Kodit të Procedurës Civile, ka marrë formë të prerë dhe është titull ekzekutiv, i cili duhet respektuar dhe zbatuar nga ana e institucionit tuaj. Kushtetuta e Shqipërisë në nenin 142 ka përcaktuar se:

*“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.*

Në nenin 451/ të Kodit të Procedurës Civile thuhet shprehimisht se:

*“Vendimi që ka marrë formë të prerë është ë detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.*

*Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për ç'ka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe.”*

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se : “Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

### **REKOMANDOJMË:**

*Ekzekutimin e vendimit nr. 5149 datë 21.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë: “Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, të rillogarisë dhe t’i paguajë paditësit E.Q pensionin parakohshëm për vjetërsi shërbimi si ushtarak sipas nenit 11 të Ligjit nr.8087 datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ushtarakëve të Ministrisë së Rendtit dhe Shërbimit Informativ Kombëtar”, i ndryshuar me Ligjin nr.8521 datë 30.07.1999, që nga data 01.11.2011 në shumën 18037 lekë në muaj, e indeksuar sipas rritjeve të viteve 2011-2012 si dhe pagimin e diferencave të krijuara nga moszbatimi korrekt i ligjit nga data 01.01.1999 deri më datë 30.06.2009”.*

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet shprehimisht se: “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta rishqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

**AVOKATI I POPULLIT**  
**Igli TOTOZANI**

Me Urdhër dhe me Porosi  
ND/KOMISIONER  
**Frederik PASKALI**

